

## PUSHTETI, KUJTESA DHE HARRESA NË ROMANIN 'TË FSHEHTAT E TREGUARA'

**Fatjona ABDULLAHI**

*fatjona.abdullahi@unite.edu.mk*

### Abstrakt

Ky punim, trajton romanin *Të fshehtat e treguara* të Rexhep Qosjes në kontekstin postmodernist, duke analizuar pushtetin, kujtesën, harresën dhe ironinë si elemente të pranishme në rrëfim. Struktura e fragmentarizuar e romanit dhe mënyra e sfidimit të narracionit tradicional dhe të historiografisë dhe identitetit kombëtar janë karakteristikat tek të cilat do të ndalemi. Arkivi i përdorur si metaforë për të hetuar marrëdhëniet mes të kaluarës dhe të tashmes, duke theksuar mënyrat se si kujtesa dhe harresa formojnë të vërtetat individuale dhe kolektive por edhe ironia, si mjet për të kritikuar pushtetin dhe normat shoqërore, janë komponentë thelbësorë të romanit, që e vendosin në kontekst të një debati të vazhdueshëm mbi dominimin e ideve dhe formimin e identitetit.

*Fjalë kyçe:* kujtesa, pushteti, ironia, antiheroi, fragmentarizimi, qasja postmoderniste.

### Abstract

This paper examines Rexhep Qosja's novel *Të fshehtat e treguara* within a postmodernist context, analyzing power, memory, and irony as key elements of the narrative. The novel's fragmented structure and its challenge to traditional narratives, historiography, and national identity are the focal points of this analysis. The archive is used as a metaphor to explore the relationship between the past and the present, emphasizing how memory and forgetting shape both individual and collective truths. Additionally, irony, as a tool for critiquing power and social norms, plays a crucial role in the novel, situating it within an ongoing discourse on the dominance of ideas and the formation of identity.

*Keywords:* memory, power, irony, antihero, fragmentation, postmodernist approach.

### Kujtesa dhe harresa në qasjen postmoderniste

Postmodernizmi refuzon ideologjitë e një të vërtete absolute dhe është një qasje me të cilën analizohet ndarja mes të kaluarës dhe të tashmes, ashtu si dhe tematika e kujtesës dhe harresës që Qosja trajton në roman.

Në romanin *Të fshehtat e treguara* Rexhep Qosja edhe një herë sfidon strukturat tradicionale të narracionit dhe eksploron tema universale me qasje postmoderniste. Ky roman e ndërthur trajtimin e temave komplekse me një stil që shkrin të vërtetën dhe gabimin, ndërsa krijon një gërshetim mes subjektivitetit dhe objektivitetit. Analiza jonë, e mbështetur në teoritë e autorëve si Jean-François Lyotard, Jacques Derrida apo Michel Foucault, do të shqyrtojë narracionin, tematikën, ironinë dhe portretizimin e personazheve, duke u fokusuar në mënyrën se si këta elementë kontribuojnë në formësimin e romanit si një kritikë postmoderne e shoqërisë dhe narrativave të saj tradicionale.

Qosja përdor një stil të veçantë narrativ që kombinon dialogun me monologun e brendshëm, duke krijuar një lidhje intime midis lexuesit dhe protagonistëve. Ai shpesh herë sfidon lexuesin me pyetje retorike dhe refleksione filozofike, duke e bërë romanin jo vetëm një histori për t'u lexuar, por edhe një material për mendim. Qosja në këtë kontekst, përdor ironinë për të kultivuar kritikë ndaj pushtetit dhe normave shoqërore, si një instrument për të ekspozuar shtypjen e individëve nga struktura të panjohura dhe të pasigurta të pushtetit.

## Fragmentarizimi i rrëfimit dhe i mendimit

Rrëfimi është ndërtuar në mënyrë jolineare, duke alternuar mes reflektimeve dhe ngjarjeve konkrete, një strukturë që sjell një tekst shumëdimensional dhe të hapur për interpretime të shumëfishta, në përputhje me idenë e Lyotardit rreth “legjitimitimit përmes mosnarrativave.” Kjo strukturë i mundëson romanit të shmangë një të vërtetë të vetme, duke u përqëndruar në mënyrën se si individët dhe shoqëritë krijojnë, ruajnë dhe deformojnë realitetin e tyre. Në veprën *The Postmodern Condition*, Lyotard-i e argumenton si dukuri postmoderniste refuzimin e narrativave të mëdha dhe promovimin e fragmentimit, si teknikë e cila reflektohet në mënyrën e ndërtimit të narrativës në romanin postmodern. Ai thekson se “Postmodernizmi karakterizohet nga një mosbesim ndaj metanarrativave” (Lyotard, 1984). Kështu rrëfimtari, që shpesh shfaqet si vetëreflektues dhe i pasigurt, e sfidon veten dhe lexuesin me mendime të paplotësuara dhe të ndara. Ky vetëdijësim për procesin e krijimit dhe zgjidhjen e dyshimeve për të vërtetën bën një përshkrim të krizës postmoderne të identitetit: “Të shkruajë për një të vërtetë që i thuhet e të mos shkruajë për tjetër që ai do” (Qosja, 2020), është një shprehje e qartë e fragmentimit të mendimit dhe realitetit, ku çdo histori nuk është e mbyllur dhe gjithmonë ka një të dhënë tjetër të papritur.

Jacques Derrida, në *Archive Fever*, i jep një dimension të ri konceptit të arkivit, duke e trajtuar si një hapësirë ku kujtesa është njëkohësisht e ruajtur dhe e deformuar, sipas tij nuk ka pushtet politik pa kontrollin e arkivit, nëse jo të kujtesës (Derrida, 1995). Ky koncept është thelbësor për kuptimin e arkivit në romanin e Qosjes, ku arkivisti Bardhi reflekton mbi arkivin si një “vend i ruajtjes dhe i harresës” (Qosja, 2020). Kjo metaforë përshkruan më së miri pasigurinë që ekziston rreth të kaluarës dhe të vërtetës, që shihet si shuar dhe e zhdukur nëpërmjet kujtesës selektive.

Për Bardhin, arkivi është më shumë se një thesar të dhënash, ai është një hapësirë ku fuqia dhe dinamika e kujtesës formojnë realitete të ndryshme. Ky trajtim postmodern i arkivit sfidon idenë e të vërtetës absolute dhe nxjerr në pah manipulimet që ndodhin në mënyrën se si historia ruhet dhe transmetohet.

Ironia, siç përmendëm është gjithashtu një nga elementët ndërtues të romanit, që shfaqet përmes dialogëve dhe reflektimeve që e zbulojnë absurditetin e realitetit shoqëror. Michel Foucault, në *Discipline and Punish*, e shqyrton ndikimin e pushtetit në çdo aspekt të jetës dhe thotë se “Pushteti nuk është një institucion dhe as një strukturë; ai është emri që i japim një situatë strategjike të ndërlikuar në një shoqëri të caktuar” (Foucault, 1977). Ai bën një analizë të pushtetit si një forcë që përshkon dhe rregullon të gjitha nivelet e shoqërisë, duke krijuar një lloj “panoptizmi” që e bën individin të brendësojë kontrollin dhe disiplinën dhe argumenton se pushteti nuk është më vetëm një strukturë hierarkike dhe eksternale, por një mekanizëm që vepron në nivele të ndryshme, duke përfshirë trupin, mendjen dhe sjelljen e individëve dhe e sheh pushtetin si një rrjet të lidhur dhe të shpërndarë, i cili është i pranishëm në çdo aspekt të jetës shoqërore, nga institucionet, shkolla, spitalet, deri te marrëdhëniet e përditshme ndërmjetëzore. Kjo është pasqyruar edhe në romanin e Qosjes *Të fshehtat e treguara*, ku ndikimi i pushtetit është theksuar përmes marrëdhënieve komplekse mes individëve dhe shoqërisë. Pushteti në këtë roman nuk është vetëm një strukturë autoritare, por një forcë që manifeston veten në nivelin mikro të jetës sociale dhe personale, nëpërmjet ideologjive, kontrollit të kujtesës dhe rregullave të pashkruara të shoqërisë. Personazhi i Bardhit është një shembull i mënyrës se si individ i përballet me fuqinë e pushtetit dhe kërkon të nxjerrë kuptim nga një realitet i manipuluar dhe i mbushur me kontradikta. Pushteti që udhëheq dhe kontrollon individin, është i pranishëm edhe në mënyrën se si ai përballon arkivin si një objekt të pasigurisë dhe manipulimit, duke dëshmuar për një formë tjetër të kontrollit social. Ndërkaq, edhe dialogët mes Bardhit dhe Havasë, veçanërisht ato mbi zvarritjen e këmbës (fq. 34), janë shembuj të një ironie të hollë që zbulojnë tensione të fshehura dhe realitete të ndryshme, të cilat i japin

personazheve një rëndesë të madhe psikologjike dhe sociale. Kjo ndihmon në ndërtimin e një diskursi që sfidon normat dhe të kuptuarit tradicional të marrëdhënieve njerëzore dhe shoqërore.

### **Personazhi antihero dhe subversioni i heroizmit tradicional**

Në letërsinë postmoderne, heroizmi tradicional shpesh i është nënshtruar subversionit. Kështu Bardhi, si antihero, refuzon të angazhohet në misione madhore ose të nxisë ndryshime të mëdha. Ai është një intelektual dyshues dhe një meditues që heziton të përballojë sfidat e mëdha të jetës, duke pasur një ndikim minimal në realitetin që e rrethon. Ky portretizim i antiheroit pasqyron një tipar të rëndësishëm të postmodernizmit, siç është trajtuar nga Linda Hutcheon e cila edhe thekson se letërsia postmoderne nuk përfaqëson thjesht historinë; ajo gjithashtu problematizon të gjithë çështjen e njohjes historike (Hutcheon, 1988). Në *A Poetics of Postmodernism*, Linda Hutcheon ofron një analizë të asaj që ajo e quan antiheroizëm në letërsinë postmoderne. Sipas Hutcheon, postmodernizmi shpesh refuzon idetë tradicionale të heroizmit dhe e sfidon konceptin e individit që vepron për të shpëtuar shoqërinë. Heroi i letërsisë moderne, që është një personazh i fortë, i drejtë dhe i vendosur, i angazhuar për një mision të shenjtë ose shpëtues, është i zëvendësuar nga figura e antiheroit – një individ që nuk ndjek një rrugë të drejtpërdrejtë, shpesh është i pasigurt, dhe ndonjëherë edhe cinik ndaj idesë të ndryshimit shoqëror apo moral. Ky antihero postmodern nuk është një shpëtimtar, por një individ që është i lidhur me kompleksitetin e jetës dhe konfliktet e brendshme.

Në romanin *Të fshehtat e treguara*, ku personazhet janë të thyer dhe të komplikuar, duke u larguar nga figura e heroit tradicional që e shpëton shoqërinë, portretizimi i Bardhit si antihero pasqyron këtë tendencë të postmodernizmit për të dekonstruuar idenë e heroit tradicional. Bardhi është një personazh që sfidon pritshmëritë për të qenë figura shpëtimtare ose udhëheqëse. Ai është i ndikuar nga dyshime dhe pasiguri, duke reflektuar mbi jetën dhe kuptimin e saj pa pasur ndonjë aspiratë për të realizuar ndonjë mision madhor ose për të ndikuar në shoqërinë në mënyrë të drejtpërdrejtë. Pra, si në letërsinë postmoderne, në romanin e Qosjes antiheroi është një portretizim i një individi të thyer, që nuk ka një vizion të qartë për të ardhmen, dhe që në vend të shpëtimit, përfshihet në një reflektim të thellë mbi realitetin dhe identitetin.

Ky lloj antiheroi, i cili nuk ka aspiratë heroike tradicionale, është në një dialog të vazhdueshëm me konceptet e fuqisë, normave dhe realiteteve të shoqërisë, të cilat janë shpesh të paspecifikuara dhe të pasigurta. Bardhi është një shembull i këtij antiheroizmi, që në vend të veprimeve heroike për të shpëtuar shoqërinë, vepron për të kuptuar dhe përballuar vetë realitetin, pa e shpresuar ndihmën nga një hero i jashtëm.

### **Përfundim**

*Të fshehtat e treguara* është një roman postmodern në letërsinë shqipe i cili vjen duke sfiduar narrativat tradicionale dhe duke eksploruar tematika të thella dhe komplekse përmes fragmentimit, ironisë dhe personazheve të ndërlikuar dhe krijon një tekst që jo vetëm që shpërfaq realitetin, por gjithashtu detyron lexuesin të reflektojë mbi natyrën e asaj që është e vërtetë, e mundshme dhe e ruajtur. Ky roman është një kritikë e fuqishme ndaj mënyrës se si shoqëritë krijojnë dhe menaxhojnë të kaluarën dhe të tashmen, dhe është një thirrje për të vënë në dyshim gjithçka që kemi pranuar si të vërtetë.

## Referencat

- [1]. Derrida, J. (1995). *Archive fever: A Freudian impression* (E. Prenowitz, Trans.). University of Chicago Press.
- [2]. Foucault, M. (1977). *Discipline and punish: The birth of the prison* (A. Sheridan, Trans.). Pantheon Books.
- [3]. Hutcheon, L. (1988). *A poetics of postmodernism: History, theory, fiction*. Routledge.
- [4]. Lyotard, J.-F. (1984). *The postmodern condition: A report on knowledge* (G. Bennington & B. Massumi, Trans.). University of Minnesota Press.
- [5]. Qosja, R. (2020). *Të fshehtat e treguara*. Toena, Tiranë.